




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep: 2-0/DPK  
 Nr. Prot: 01-1256/14  
 Dep: 01-1256/14  
 Prot No: 01-1256/14  
 Nr. Llog: \_\_\_\_\_  
 Date: 02-04-2014  
 Broj shtetlica: \_\_\_\_\_  
 Date: 02-04-2014  
 Nr. pages: \_\_\_\_\_  
 Date: 02-04-2014  
 PRISTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.04.2014, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3551-13 për z.Kadri Kadrijaj – Drejtor i Inspektoriatit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës, për shkak se është parandaluar situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-02-3551-13, për Zyrtarin e lartë, z.Kadri Kadrijaj – Drejtor i Inspektoriatit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z.Kadri Kadrijaj fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Kadrijaj, është deklaruar se do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuara për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Kadrijaj, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-1175/14) në të cilën ai nuk ka bërë vetëm ndryshimet e kërkuara nga AKK, por shihet se është bërë shuarja vullnetare e biznesit privat, N.T.P."Arbëri". Me këtë zyrtari Kadrijaj, ka parandaluar konfliktin e mundshëm të interesit me funksionin e tij publik – Drejtor i Inspektoriatit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

